



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës të Kosovës,

Në mbështetje të neneve 67, 72 dhe 74 të Ligjit Nr. 03/ L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të përcaktimit të kërkesave për regjistrimin e aerodromit që nuk është aerodrom i certifikuar apo i aprovuar, i destinuar për shfrytëzim nga operatori i avionëve, cili e ka regjistruar aerodromin, dhe nga operatorët e tjerë të avionëve me leje për shfrytëzim të atij aerodromi,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me palët e interesuara, sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2012 mbi procedurat për konsultim publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

**RREGULLORE Nr. 9/2015**  
**MBI AERODROMET E REGJISTRUARA**

**Neni 1**  
**Fushat e Aplikimit**

Rregullorja aplikohet për:

- a) Operatorët e avionëve të cilët synojnë të regjistrojnë një aerodrom që nuk është aerodrom i certifikuar apo i aprovuar.
- b) Operatorët e avionëve me leje për shfrytëzimin e aerodromit të regjistruar, që ofrohet nga operatori cili ka regjistruar aerodromin.

**Neni 2**  
**Fushëveprimi**

2.1 Aerodromi i regjistruar mund të shfrytëzohet vetëm për operimet e fluturimeve jo-komerciale me rregullat vizuale të fluturimit gjatë ditës.

2.2 Aerodromi i regjistruar nuk publikohet në Publikimin e Informacioneve Aeronautike të Republikës së Kosovës.

2.3 Me përjashtim të paragrafit 2.1 të këtij neni, AAC-ja mund t'i lëshojë çdo operatori të avionit, leje të veçantë për të shfrytëzimin e aerodromit të regjistruar për të kryer operime me qëllim të:

- a) realizimit të fluturimeve komerciale, që fillojnë dhe përfundojnë në të njëjtin aerodrom të regjistruar dhe që zhvillohen brenda rrezes deri në 50 milje nautike nga aerodromi, ose
- b) trajnimit të ekuipazhit të avionit, duke pasur parasysh sigurinë e operimeve dhe numrin e operimeve në aerodrom.

### **Neni 3 Termet dhe përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat e përdorura në këtë dokument kanë këtë kuptim:

**“Aerodrom”** - një fushë të caktuar në tokë (duke përfshirë çfarëdo ndërtese, instalim dhe pajisje) që mëton të shfrytëzohet tërësisht apo pjesërisht për aterrim, nisje dhe lëvizje sipërfaqësore të avionëve. Në këtë rregullore, termi Aerodrom përfshinë fushat ajrore dhe fushat e planerimit;

**“Operator i Avionit”** personi, organizata apo ndërmarrja e angazhuar apo që ofron të angazhohet në operime të avionit;

**Aerodromi i Regjistruar** - një zonë e destinuar për aterrim dhe ngritje të avionëve që nuk është aerodrom i certifikuar apo aprovuar.

**Operime komerciale të fluturimeve**- për qëllime të kësaj rregulloreje nënkupton çdo operim në të cilin mjete ajror përdoret për aktivitete speciale si në; bujqësi dhe blegtori, ndërtimtari, fotografim, përcjellje dhe vëzhgim, patrollim dhe reklamime nga ajri.

### **Neni 4 Kushtet e përgjithshme**

4.1 Kërkesa për regjistrimin e aerodromit dorëzohet nga operatori i avionit.

4.2. Aerodromi i regjistruar mund të përdoret nga operatorët tjerë të avionit me leje për shfrytëzim që e ofron operatori që ka aplikuar për regjistrim, në pajtim me nenin 5.2 d).

4.3. Përgjegjësia për sigurinë e operimeve të avionëve bie mbi operatorin e avionit që shfrytëzon aerodromin e regjistruar.

## **Neni 5**

### **Kërkesa për regjistrimin e aerodromit**

5.1 Për të regjistruar aerodromin, operatori i avionit duhet të dorëzojë kërkesën për regjistrimin e aerodromit, në formë të shkruar, te Departamenti për Aerodrome në Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës të Kosovës.

5.2 Kërkesa për regjistrimin e aerodromit duhet të përmbajë informatat në vijim:

- a) Informatat e hollësishme lidhur me aplikuesin (të dhënat personale apo të dhënat e personit juridik, adresa),
- b) Arsyet e dorëzimit të kërkesës për regjistrimin e aerodromit,
- c) Emri i zonës si dhe i vendbanimit më të afërt, koordinatat gjeografike të pikës referuese të shprehura në Sistemin Gjeodezik Botëror-1984 (WGS-84) i verifikuar nga gjeodetë të autorizuar,
- d) Deklarata a aplikuesit që karakteristikat fizike të aerodromit janë në përputhje me kërkesat teknike të avionëve që do të shfrytëzojnë aerodromin.

5.3 Dokumentet e mëposhtme duhet t'i bashkëngjiten kërkesës për regjistrimin e aerodromit:

- a) Deklaratën e aplikuesit, e verifikuar nga noteri se pronari, poseduesi i aerodromit, apo personi juridik/fizik me të drejtën e shfrytëzimit të aerodromit, pajtohet që aplikuesi mund të shfrytëzojë aerodromin e tij/saj për ngritje dhe aterrim të avionit, dhe me kërkesat e nenit 6, par. 5.
- b) Plani me përmasa (harta) i aerodromit, me shkallën e përpjesëtimit të caktuar dhe përshkrimin e shkurtër të sipërfaqes (në dhe, bari, , betoni asfalt-beton apo tjetër) drejtimet më të mira për afrim, aterrim dhe ngritje, pengesat e ndjeshme (të cilat mund të ndikojnë në sigurinë e operimeve) në vetë zonën, apo në rrethinën e saj.

5.4 Gjatë vlerësimit të kërkesës për regjistrimin e aerodromit, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të kërkojë dokumente shtesë, sipas nevojës.

## **Neni 6**

### **Regjistrimi i aerodromit**

6.1 Autoriteti i Aviacionit Civil do të bëjë regjistrimin e aerodromit nëse aplikuesi i plotëson të gjitha kërkesat e përshkruara nga kjo Rregullore. Varësisht nga deklarata e aplikuesit në lidhje me pajtueshmërinë e pronarit, poseduesit të aerodromit, apo personit juridik/fizik me të drejtën e shfrytëzimit të aerodromit - nga neni 5.3 (a), nevojat e aplikuesit dhe kushtet e aerodromit, regjistrimi lejohet për periudhë kohore të caktuar apo të pacaktuar.

6.2 Regjistrimi i aerodromit skadon pas skadimit të periudhës së caktuar për të cilën është regjistruar.

6.3 Autoriteti Civil i Aviacionit mund të fshijë nga Regjistri aerodromin e regjistruar para periudhës së skadimit për të cilën është regjistruar, në rast se:

- a) Gjatë procesit të aplikimit, janë ofruar informacione të pasakta dhe të pavërteta nga operatori i avionit,
- b) Veprimet dhe procedurat e operatorit të avionit rrezikojnë sigurinë e trafikut ajror, apo i shkaktojnë dëme palëve të treta,
- c) Operatori i avionit nuk vepron në përputhje me Rregulloren dhe kërkesat ligjore për regjistrimin e aerodromit si dhe rregullat dhe rregulloret e zbatueshme për trafikun ajror në përgjithësi.

6.4 Operatori i avionit të cilit i është refuzuar kërkesa apo ka tërhequr kërkesën për regjistrim të aerodromit, mund ta përsëris kërkesën pasi të jetë eliminuar shkakui i refuzimit apo tërheqjes.

6.5 Regjistrimi i aerodromit nuk ndikon në asnjë mënyrë në të drejtat e pronarit apo poseduesit në këtë aerodrom. Gjatë aplikimit për regjistrim, aplikuesi deklaron, nën përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, që ai/ajo nuk do ta shfrytëzoj aerodromin në atë mënyrë që do të rrezikonte të drejtat e pronarit apo poseduesit.

6.6 Gjatë procesit të regjistrimit, Autoriteti i Aviacionit Civil do të verifikojë përshtatshmërinë e aerodromit. Autoriteti i Aviacionit Civil nuk është përgjegjës për gjendjen e aerodromit të regjistruar pas regjistrimit

## **Neni 7 Njoftimi dhe raportimi**

Operatori i avionit që shfrytëzon aerodromin e regjistruar duhet të informojë Autoritetin e Aviacionit Civil për çdo ndodhi që ka të bëjë me sigurinë dhe sigurimin e trafikut ajror, apo të ndonjë akti në kundërshtim me legjislacionin vendor, të ndodhur gjatë operimeve të avionit në aerodromin e regjistruar.

## **Neni 8 Siguria e operimeve të aterimit dhe ngritjes së avionit në aerodromin e regjistruar.**

8.1. Para fillimit të operimeve të fluturimit, piloti komandues duhet të ekzaminojë duke ecur në të gjitha sipërfaqet e destinuara për shfrytëzim.

8.2. Pasi të parkohet avioni, piloti komandues duhet ta sigurojë avionin nga lëvizja e padëshiruar.

8.3. Gjatë planifikimit të fluturimit, piloti komandues dhe operatori i avionit duhet të kenë parasysh si në vijim:

- a) specifikat e procedurave të ngritjes dhe aterimit,
- b) gjendjen e sipërfaqes së ngritjes dhe aterimit,
- c) karakteristikat e aerodromit të zgjedhur dhe atij alternativ për ngritje dhe aterim.

8.4. Gjatë lëvizjes së avionit, piloti komandues sigurohet që krahu, helika ose pjesët tjera të avionit gjatë lëvizjes të mos vijnë në kontakt me personat, kafshët, objektet në sipërfaqe, automjetet, cisternat, etj.

8.5. Nëse piloti komandues synon të shfrytëzoj ndihmën e ndonjë personi në tokë, ai paraprakisht duhet të informojë atë person për kërkesat e sigurisë (informimin për siguri) dhe të sigurohet se ai person është në gjendje të ofrojë ndihmë adekuate.

8.6. Krahas informimit të detyrueshëm të udhëtarëve jo komercial, piloti komandues është i obliguar që gjithashtu t'i informojë udhëtarët:

- a) Që, operimi realizohet nga/në sipërfaqen e pa-certifikuar, që mund të mos i plotësoj kërkesat standarde operimeve të sigurisë,
- b) Që, në rast të kryerjes së operimeve jo-komerciale, përveç ngjarjeve të mbuluara me polisë sigurimi të lëshuar në përputhje me aktet përkatëse ligjore, fluturimi realizohet në përgjegjësinë e tyre.
- c) Për rreziqet e mundshme, në lidhje me një operim të tillë.

8.7. Operatori i avionit dhe piloti komandues i cili kryen operime të ngritjes nga aerodromi i regjistruar tek aerodromi i aprovuar ose certifikuar, është i detyruar të aplikojë masa alternative të sigurimit të përcaktuara për operime të tilla në fushat e mëposhtme:

- a) mbrojtjen e avionit nga hyrja e paautorizuar,
- b) kontrollimi i identitetit të udhëtarëve,
- c) të regjistrojnë listën e udhëtarëve,
- d) kontrolli i sigurimit për udhëtarët dhe bagazhin,
- e) bartjen e armëve dhe informimi i shërbimeve relevante të aerodromit.

8.8. Gjatë kryerjes së operimeve në zonën e kontrolluar ajrore të aerodromit (CTR), piloti komandues duhet:

- a) Para se të ngritet, të vendos komunikimin me radio me kontrollorin e trafikut ajror të aerodromit;
- b) Nëse nuk është në gjendje të vendos komunikim me radio, leja nga kontrollori i trafikut ajror për fluturim duhet të merret përmes telefonit. Kontrolli i trafikut ajror përgjegjës nuk mund të jap leje për ngritje apo aterim;

- c) Para aterimit në zonën e kontrolluar (CTR), kërkon elementet e procedurës së shmangjes së aterimit (missed approach) (lartësia dhe drejtimi i lejuar) dhe pastaj raporton largimin nga frekuenca e kontrollit të trafikut ajror.
- d) Ruan planin e fluturimit, nëse kërkohet.

8.9. Kur zhvillohen operime të njëkohshme nga më shumë se një operator avioni në të njëjtin aerodrom të regjistruar, operatorët janë përgjegjës për koordinim adekuat të aktiviteteve të fluturimit.

8.10. Kur një apo më shumë operatorë avionësh operojnë shpesh në aerodromin e regjistruar, rekomandohet të sigurohen shërbimet e zjarrfikësve, të vendoset treguesi i erës dhe shënjimi standard horizontal për sipërfaqet operative.

8.11. Para operimeve, piloti komandues dhe operatori i avionit duhet të bëjnë vlerësim të rrezikut dhe të zbatojnë masa lehtësuese për të parandaluar ngjarjet e padëshirueshme.

8.12. Gjatë vlerësimit të rrezikut operatori dhe piloti komandues duhet të kenë parasysh burimet e mundshme të rrezikut, gjegjësisht:

- a) njohuritë, aftësitë dhe përvojën në operimet e ngritjes dhe aterimit në aerodromet e regjistruara,
- b) karakteristikat dhe performancën e avionit,
- c) pajisjet e avionit për fluturim,
- d) karakteristikat e sipërfaqes në raport me kufizimet e shikimit vizual (reflektimit etj.),
- e) gjendja e sipërfaqes (pengesat, prania e personave dhe kafshëve, objektet, automjetet, etj.),
- f) kufizimet në lokacion dhe në drejtimin për ngritje dhe aterim për shkak të pengesave apo konfigurimit të terrenit përreth,
- g) drejtimi i erës dhe karakteristikat,
- h) shërbimet e shpëtimit në dispozicion,
- i) përmasat e hapësirës dhe distanca nga objektet apo zonat e aktiviteteve,
- j) tjetër trafik ajror,
- k) kufizimet si rrjedhojë e legjislacionit të aviacionit,
- l) praktikat më të mira të rekomanduara përfshirë informatat e pranuar nga operatorët tjerë të avionëve të cilët kanë përdorur aerodromin e regjistruar,
- m) dëshmitë dhe informatat e marra duke ecur përreth aerodromit,
- n) kufizimet specifike në aerodrom të lëshuara nga autoriteti përgjegjës,
- o) sinjalet në objekte në lidhje me rregullat e qasjes dhe lëvizjes në aerodromin e regjistruar.

8.13. Piloti komandues duhet të fluturojë përmbi aerodromin në të cilin planifikon të aterroj, me trajektoren e cila mundëson kontakt vizual të vazhdueshëm me sipërfaqen e aerodromit, në mënyrë që të:

- a) kryej verifikimin e fundit të kushteve para vendimit përfundimtar për aterim dhe për drejtimin,
- b) t'i njoftoj personat në aerodrom dhe rrethinë për synimin e tij për aterim,

- c) verifikojë gjendjen e sipërfaqes, pengesat, drejtimin e erës, karakteristikat dhe shpejtësinë, praninë e gjësendeve dhe objekteve mbi sipërfaqe, praninë dhe drejtimin e lëvizjes së personave dhe kafshëve në rrethinë, dhe,
- d) të përcaktojë planin për lëvizje të sigurt të avionit pas aterrimit deri tek ndalesa finale (p.sh. në vend parkim).

8.14. Gjatë aterrimit dhe ngritjes, piloti komandues duhet të sigurohet:

- a) që aerodromi ka gjatësinë dhe gjerësinë e duhur në raport me performancën e avionit, ku distanca e kërkuar për aterrim/ngritje është distanca e kërkuar nga Manuali i Fluturimit të Avionit apo dokument ekuivalent e rritur për 30%. Sidoqoftë, gjatësia e sipërfaqes së përdorur për aterrim dhe ngritje nuk mund të jetë më pak se 250 metra ndërsa gjerësia nuk mund të jetë më pak se 15 metra,
- b) mënyrën më të përshtatshme të veprimit për aterrim alternativ në rast të prishjes së motorit gjatë ngritjes,
- c) ai/ajo të jenë në gjendje t'i kalojë të gjitha pengesat në shtegun e ngritjes për më së paku 50 feet (15 m),
- d) që trajektorja për afrim apo ngritje është e atillë që avioni është tërë kohën 500 feet (150 m) larg nga objektet apo grupet e njerëzve.

### **Neni 9**

#### **Sigurimi i trafikut ajror në aerodromin e regjistruar**

Autoriteti përgjegjës për sigurimin në trafikun ajror në Republikën e Kosovës është Ministria e Punëve të Brendshme. Operatori i avionit që synon të regjistrojë një aerodrom duhet të koordinohet me autoritetin përgjegjës në lidhje me sigurimin në trafikun ajror në aerodromin e regjistruar.

### **Neni 10**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 nëntor 2015.

Prishtinë, 6.10. 2015.

**Dritan Gjonbalaj**  
Drejtore i Përgjithshëm